**KËSHILLI I BASHKISË**
**K O R Ç Ë**

---

# VENDIM

**Nr** 15 **Datë** 12. 3. 2010

## PËR NIVELIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE DHE ADMINISTRIMIN E TYRE NË QYTETIN E KORÇËS SI DHE PENALITETET PËR SHKELJET APO KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Këshilli i Bashkisë Korçë në mbledhjen e tij të datës së sotme pasi morri në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e të Ardhurave, bazuar në Ligjin Nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" neni 35 dhe në Ligjin Nr.8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" Ligjin nr 9920 datë 19.05.2008 "Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr 24 datë 02.09.2008 "Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë",

## VENDOSI :

1. Të miratojë nivelet e mëposhtme të taksave dhe tarifave vendore si më poshtë vijon :

**A.TAKSAT VENDORE**

**Llojet, baza tatimore, kategorizimet dhe nënkategorizimet, këstet e pagimit, koha e kryerjes së tyre dhe agjenti tatimor.**

### 1. TAKSA VENDORE MBI BIZNESIN E VOGËL.

Taksa vendore mbi biznesin e vogël llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit, qoftë ky subjekt fizik apo juridik, vendas apo i huaj, që realizon një të ardhur bruto vjetore (qarkullim) më të vogël apo të barabartë me 8.000.000 lekë.

Taksa paguhet në katër këste të barabarta. Kësti i parë paguhet brenda datës 20 Prill. Kësti i dytë jo më vonë se data 20 Korrik, kësti i tretë jo më vonë se data 20 Tetor dhe kësti i fundit jo më vonë se data 20 Janar e vitit të ardhshëm fiskal.

**Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës vendore mbi biznesin e vogël është Drejtoria e të Ardhurave pranë Bashkisë Korçë.**

Dixhitalizuar nga Qendra CIP
www.infocip.org

Kategoritë e bazës dhe nivelet e taksës vendore mbi biznesin e vogël paraqiten si më poshtë vijojnë:

**NË MIJË LEKË**

| Nr | Xhiro/aktivitet | Deri në 2000 | 2000 - 3000 | 3000 - 4000 | 4000 - 5000 | 5000 - 6000 | 6000 - 7000 | 7000 - 8000 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| a) | **Shitje me pakicë** :<br>Çdo njësi tregëtimi bulmet, mish, peshk.<br>Çdo njësi tregëtimi fruta – perime, ushqimore.<br>Çdo njësi tregëtimi artikuj industriale (veshje, parfumeri, argjendari, etj)<br>Bar – Bufe, restorant, pub, diskoteka, kafe – internet, fast – food, lojra fati,etj të ngjashme me to. | 25 | 48 | 63 | 78 | 93 | 108 | 123 |
| b) | **Shitje me shumicë** :<br>Magazina dyqane etj të cilat realizojnë shitje me shumicë të artikujve që tregëtojnë. | 25 | 48 | 63 | 78 | 93 | 108 | 123 |
| c) | **Prodhim :**<br>Përpunim duralumini, metalesh, druri, tapicerie, letre, kartoni,etj të ngjashme me to.<br>Prodhim tulla, tjegulla, blloqe betoni, furra gëlqereje etj të ngjashme me to.<br>Prodhime me karakter ushqimor si : prodhime buke, ëmbëlsirash, mishi, peshku, bulmeti, pijesh, etj të ngjashme me to.<br>Prodhim konfeksionesh etj të ngjashme me to.<br>Prodhim përpunim produktesh farmaceutike etj të ngjashme me to. | 23 | 45 | 60 | 75 | 90 | 105 | 120 |
| d) | **Shërbime :**<br>Riparimi i artikujve elektro shtepiake, radio televizorë, frigoriferë, lavatriçe, magnetofonë, pajisje fonie etj të ngjashme me to.<br>Shërbime fotokopimi, sallon bukurie, autoservise, kurse për makina (autoshkolla) për traktorë, për kompjuter e për parukeri, agjensi doganore, agjensi këmbimi valutor, agjensi turizmi, motele, pikat e shërbimit të makinave (autoservis), parkim i makinave, lavanteritë, pastrimi kimik, shërbime të rojeve civile, sallat e lojrave të ndryshme (gjimnastikë, aerobi, cirqe, kënde lojrash për fëmijë, pingpong etj) etj shërbime të ngjashme me shërbimet e lartpërmendura. | 20 | 43 | 58 | 73 | 88 | 103 | 118 |
| e) | **Profesione te lira :**<br>Avokat, noter, mjek, mjek laborant, stomatolog, farmacist, ekonomist kontabël të miratuar, ekspert kontabël të autorizuar, mësues, veteriner, agronom, botues, inxhinier, arkitekt, projektues, etj profesione të lira të cilat ushtrohen në njësi fikse apo ambiente të ndryshme.<br>Galeritë e artit të piktoreve, skluptorëve dhe artistëve të tjerë që prodhojnë dhe tregëtojnë objekte artistike. | 30 | 53 | 68 | 83 | 98 | 113 | 128 |



Dixhitalizuar nga Qendra ÇIP
www.infocip.org

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Institucionet jopublike të edukimit (shkollat, kopshtet apo çerdhet), shërbimet në klinika të specialiteteve të ndryshme mjekësore, shërbimet në loboratorët e diagnostifikimit etj në rastet kur nuk e kalojnë kufirin e kalimit në T.V.SH. | | | | | | | |
| f) | **Ambulant:**<br>Subjekte që nuk kanë vendndodhje fikse si shitësit e akulloreve, pijeve freskuese, gazetave, revistave, bananeve, zbukurimeve artistike, veshmbathjeve, llustraxhinjve etj të kësaj natyre<br>Tregëtia ambulante në tregje publike të miratuar nga njësia e qeverisjes vendore dhe tregjet private. | 5 | | | | | | |
| g) | **Transport** | | | | | | | |
| 1) | ***Transport pasagjerësh*** | | | | | | | |
| | Automjet deri 5 vende | 17,5 | - | - | - | - | - | - |
| | Automjet 6-9 vende | 35 | - | - | - | - | - | - |
| | Automjet 10-25 vende | 40 | - | - | - | - | - | - |
| | Automjet 26-42 vende | 45 | | | | | | |
| | Automjet mbi 42 vende | 48 | | | | | | |
| 2) | ***Transport Mallrash*** | | - | - | - | - | - | - |
| | Automjet deri 2 tonë | 28 | - | - | - | - | - | - |
| | Automjet 2-5 tonë | 40 | - | - | - | - | - | - |
| | Automjet 5-10 tonë | 48 | - | - | - | - | - | - |
| | Automjet 10-16 tonë | 50 | - | - | - | - | - | - |
| | Automjet mbi 16 tonë | 75 | - | - | - | - | - | - |
| 3) | ***Transport Ujor*** | | | | | | | |
| | Transport detar brenda vendit | 55 | - | - | - | - | - | - |
| | Transport në liqene brenda vendit | 48 | - | - | - | - | - | - |
| | Varka për shëtitje | 15 | - | - | - | - | - | - |

- Për individët **studentë** të cilët janë diplomuar në vitet 2007, 2008, 2009 dhe gjatë vitit 2010, që do të hapin një aktivitet biznes i vogël në territorin e Bashkisë Korçë, gjatë periudhës **01.01.2010 – 31.12.2010,** për periudhën e vitit 2010 gjatë së cilës do të ushtrojnë aktivitet, do të paguajnë **30%** më pak të taksës vendore të biznesit të vogël.
- Për individët që do të hapin aktivitet me objekt **turizmin si Bed & Breakfast, Agjensi Turistike, autobus turistik – city tour, restorante të mirëfillta si dhe agjensi organizimi eventesh të ndryshme festive,** gjatë periudhës **01.01.2010 – 31.12.2010,** për periudhën e vitit 2010 gjatë së cilës do të ushtrojnë aktivitet, do të paguajnë **30%** më pak të taksës vendore të biznesit të vogël.
- 10 (dhjetë) bizneset që do të hapen në kuadrin e **projektit Shërbime Punësimi për të rinjtë** (Young Enterpreneur Service), gjatë periudhës **01.01.2010 – 31.12.2010,** për periudhën e vitit 2010 gjatë së cilës do të ushtrojnë aktivitet, do të paguajnë **30%** më pak të taksës vendore të biznesit të vogël.
- 10 (dhjetë) bizneset që do të hapen në kuadrin e **projektit të UNICEF – it** (personat që janë në skemën e ndihmës ekonomike dhe do të hapin një aktivitet privat) gjatë periudhës **01.01.2010 – 31.12.2010,** për periudhën e vitit 2010 gjatë së cilës do të ushtrojnë aktivitet, do të paguajnë **30%** më pak të taksës vendore të biznesit të vogël.
- Subjektet e biznesit të vogël si bare, restorante, internet kafe, butik dhe laborator fotografik, që bëhen pjesë e projektit **PRO STUDENT,** për vitin ushtrimor 2010 do të paguajnë **20%** më pak të taksës vendore të biznesit të vogël.

Dixhitalizuar nga Qendra ÇIP www.infocip.org

- Subjektet e biznesit të vogël që do të paguajnë të plotë vlerën e detyrimit për taksën vendore për vitin në vazhdim brenda datës **31 Mars** do të paguajnë **5%** më pak të taksës vendore të biznesit të vogël.

## 2. TAKSA MBI PASURINË E PALUAJTSHME.

Në këtë zë përfshihen **Taksa mbi ndërtesën** dhe **Taksa mbi tokën bujqësore**.
**2.a Detyrimi për taksën mbi ndërtesën është vjetor.**

Nëse pasuria e taksueshme krijohet, tjetërsohet ose zhduket brenda kësaj periudhe, detyrimi i taksapaguesit llogaritet proporcionalisht vetëm për periudhën e së drejtës së pronësisë.

Baza e kësaj takse është sipërfaqja e ndërtimit në metër katror e ndërtesës ose e pjesës së saj, mbi dhe nën nivelin e tokës dhe për çdo kat. Sipërfaqja në pronësi e taksapaguesit përcaktohet sipas dokumentave që e vërtetojnë këtë pronësi. Kategoritë minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës për çdo kategori minimale të bazës për taksën mbi ndërtesën janë si vijon :

| Kategoritë minimale të ndërtesave | **Lekë/m² në vit** |
|---|---|
| **1. Ndërtesa banimi** | 8,4 |
| **II. Ndërtesa për ushtrim aktiviteti me qëllim përfitimi** | |
| - për tregëti dhe shërbime<br>- ndërtesa prodhimi<br>- ndërtesa për shërbime shëndetësore, artizanale, social kulturore, arsimore shkencore<br>- ndërtesa për shërbime tregëtare, administrative, etj<br>- të tjera (të gjitha ndërtesat që nuk përfshihen në kategoritë e mësiperme) | 150 |
| **Të tjera :**<br>- Ndërtesat në pronësi ose në përdorim të organizatave jofitimprurëse, fondacioneve.<br>- Objekte të amortizuara, të dëmtuara dhe jashtë funksionit, si dhe sipërfaqe objektesh të pashfrytëzuara ku nuk zhvillohet aktivitet. | 30 |

Për ato kategori ndërtesash banimi të cilat janë të regjistruara si seli të subjekteve tregëtare, Taksa e Pasurisë përllogaritet dhe paguhet si Kategoria II "Ndërtesa për ushtrim aktiviteti me qëllim përfitimi", për atë pjesë të sipërfaqes së ndërtesës në të cilën ushtrohet veprimtaria tregëtare, duke u përjashtuar nga Kategoria I "Ndërtesa Banimi".
**2.b Taksa mbi tokën bujqësore.**

Taksa mbi tokën bujqësore është detyrim vjetor. Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës në hektarë, në pronësi të taksa paguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumentave që e vërtetojnë atë. Kategoritë minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës për çdo kategori janë si vijon :

| Klasifikimi sipas kategorisë së tokës bujqësore | Vlera e taksës në lekë/hektar/vit |
|---|---|
| I | 4200 |
| II | 3500 |
| III | 2800 |
| IV | 2300 |
| V | 1900 |
| VI | 1600 |
| VII-X | 1400 |

Dixhitalizuar nga Qendra CIP
www.infocip.org

**Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi ndërtesën dhe taksën mbi tokën bujqësore është Drejtoria e të Ardhurave pranë Bashkisë Korçë. Për sa i përket kategorisë "çdo familje" për vitin 2010 detyrimi vjetor fiks deri në nivelin 1.000 (një mijë) lek do të shpërndahet për periudhën gusht 2010 – nëntor 2010 të vitit 2010 dhe do të paguhet së bashku me faturën mujore të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, pranë sporteleve të Ujësjellës Kanalizime Korçë.**

**3. TAKSA E FJETJES NE HOTEL.**

Niveli i taksës është **5%** e çmimit të fjetjes për person ose për dhomë, për një natë. Me **"hotel"** kuptohet çdo veprimtari, që jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim.

**Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së fjetjes në hotel është Drejtoria e të Ardhurave pranë Bashkisë Korçë.**

**4. TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA.**

Baza e taksës është vlera në lek e investimit të ri që kërkohet të kryhet.
Klasifikimi si investim i ri dhe vlerat përkatëse përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

Niveli i taksës sipas zonave është :

***ZONA "A" ME RRJET INXHINIERIK MË TË KONSOLIDUAR***

- Për banesat kolektive dhe objektet që nuk përfshihen në kategoritë e tjera, niveli i kësaj takse është **3%.**
- Për objektet administrative & shërbimi, niveli i kësaj takse është **2%.**
- Për objektet për qëllime publike si kopshte, çerdhe, shkolla, spitale qofshin këto publike apo private, niveli i kësaj takse është **1%.**
- Për ndërtimet në infrastrukturë si rrugë, ujësjellës, kanalizime, ndriçim publik, telefon (të gjitha këto publike), niveli i kësaj takse është **1%.**
- Për banesat individuale, niveli i kësaj takse është **1%.**

***ZONA "B" ME RRJET INXHINIERIK MË PAK TË KONSOLIDUAR***

- Për banesat kolektive dhe objektet që nuk përfshihen në kategoritë e tjera, niveli i kësaj takse është **2%.**
- Për objektet administrative & shërbimi, niveli i kësaj takse është **1,5%.**
- Për objektet për qëllime publike si kopshte, çerdhe, shkolla, spitale qofshin këto publike apo private, niveli i kësaj takse është **1%.**
- Për ndërtimet në infrastrukturë si rrugë, ujësjellës, kanalizime, ndriçim publik, telefon (të gjitha këto publike), niveli i kësaj takse është **1%.**
- Për banesat individuale, niveli i kësaj takse është **1%.**

***ZONA "C" ME RRJET INXHINIERIK TË PA KONSOLIDUAR***

- Për banesat kolektive dhe objektet që nuk përfshihen në kategoritë e tjera, niveli i kësaj takse është **1,5%.**
- Për objektet administrative & shërbimi, niveli i kësaj takse është **1%.**
- Për objektet për qëllime publike si kopshte, çerdhe, shkolla, spitale qofshin këto publike apo private, niveli i kësaj takse është **1%.**
- Për ndërtimet në infrastrukturë si rrugë, ujësjellës, kanalizime, ndriçim publik, telefon (të gjitha këto publike), niveli i kësaj takse është **1%.**
- Për banesat individuale, niveli i kësaj takse është **1%.**

- Për çdo lloj ndërtese, që do të plotësojë kërkesat e programit të Bashkisë Korçë për rritjen e efiçiencës së energjisë (termoizolim), niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë do të jetë **1%** për të tre zonat e lart përmendura.

Këto përqindje do të llogariten në bazë të vlerës së investimit që do të kryhet sipas kostos mesatare të ndërtimit të Entit Kombëtar të Banesave për vitin përkatës.

**4/1 TAKSA NGA NDËRTIMET E REJA PËR STUDIME PROJEKTIME.**

Dixhitalizuar nga Qendra Çip
www.infocip.org

Niveli i taksës është **1%** të vlerës së investimit që do të kryhet sipas kostos mesatare të ndërtimit të Entit Kombëtar të Banesave për vitin përkatës, fond ky i cili depozitohet për llogari të financimit të studimeve urbanistike në pushtetin vendor.

**Struktura e ngarkuar për përllogaritjen dhe lëshimin e autorizimit për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, taksës nga ndërtimet e reja për studime projektime dhe vjeljen e tyre, është Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit Urban pranë Bashkisë Korçë.**

## 5. TAKSA MBI KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURITË E PALUAJTSHME

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to. Bazuar në Ligjin nr 9716 datë 16.04.2007 "Për disa ndryshime në Ligjin nr 8438 date 28.12.1998 Për Tatimin mbi të Ardhurat", kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, tokë e ndërtesa, **tatohet me 10 për qind të fitimeve kapitale të realizuara**. Kjo nuk zbatohet në rastet e shkëmbimit të së drejtës së pronësisë mbi tokën me të drejtën e pronësisë mbi ndërtesën e ndërtuar mbi tokë. Tatimi paguhet nga individi që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit të pasurive të mësipërme, në pëputhje me aktet ligjore. Pasuria e paluajtshme nuk regjistrohet, pa provuar pagimin e detyrimit pranë zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.
Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme janë të detyruara që, brenda 10 (dhjetë) ditëve, të transferojnë për llogari të njësisë vendore (Bashkisë Korçë) taksën e paguar.

**Agjenti tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme është Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, e cila në rolin e agjentit të taksës përfiton 3% të shumës së arkëtuar dhe diferenca derdhet për llogari të buxhetit të njësisë vendore (Bashkisë Korçë) brenda 10 (dhjetë) ditëve.**

## 6. TAKSA E REGJISTRIMIT TË PËRVITSHEM TË MJETEVE.

Baza e taksës është lloji i mjetit të transportit rrugor.
Niveli i taksës shprehet në një kuotë të caktuar sipas llojit të mjetit. Kategoritë dhe nivelet sipas mjeteve përcaktohen në lidhjen përkatëse të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006.

**Agjenti tatimor për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor. Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor përfiton 5% të shumës së arkëtuar dhe Drejtoria e Qarkullimit Rrugor 1% të shumës së arkëtuar.**

## 7. TAKSA PËR ZËNIEN E HAPËSIRAVE PUBLIKE.

Baza e taksës për zënien e hapësirave publike është sipërfaqja në metër katror e cila vihet në shfrytëzim nga individë dhe subjekte për qëllime biznesi. Taksa llogaritet si detyrim mujor i taksa paguesit duke shumëzuar bazën e taksës (sipërfaqen) me nivelin tregues të saj. **Niveli i kësaj takse për Bashkinë Korçë është 90 Lekë / m² në muaj.**

**Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës për zënien e hapësirave publike është Drejtoria e të Ardhurave pranë Bashkisë Korçë.**

## 8. TAKSA E TABELËS.

Kjo taksë aplikohet për të gjitha subjektet fizike, juridike, private e shtetërore, vendas apo të huaj që kryejnë veprimtarinë e tyre brenda territorit të Bashkisë Korçë me përjashtim të tregëtareve ambulantë të cilët janë të përjashtuar, për arsye se nuk kanë detyrim për ta vendosur atë. Baza dhe niveli i kësaj takse përcaktohet nga Këshilli i Bashkisë.
Niveli i kësaj takse për Bashkinë Korçë është si më poshtë vijon :

Dixhitalizuar nga Qendra CIP
www.micip.org

- Tabelë për qëllime identifikimi 120 lekë/vit
- Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj. 1000 lekë/m2/vit

Kjo taksë aplikohet tek tabelat të cilat nuk e kalojnë përmasën 50 cm X 60cm. Detyrimi për taksën e tabelës është vjetor. Afati i pagesës është brenda datës 31 mars të vitit fiskal për subjektet e regjistruara dhe për subjektet e reja në momentin kur lind detyrimi.

**Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së tabelës është Drejtoria e të Ardhurave pranë Bashkisë Korçë.**

**9. DHËNIE AUTORIZIMI PËR PIKAT E TREGËTIMIT ME PAKICË TË KARBURANTEVE DHE NJËSITË E SHITJES SË LENDËVE DJEGËSE DHE BOMBOLAVE TË GAZIT**

Bazuar në Ligjin Nr.8450, datë 24.2.1999 "PËR PËRPUNIMIN, TRANSPORTIMIN DHE TREGËTIMIN E NAFTËS, TË GAZIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE" të ndryshuar me Ligjin Nr .9218, datë 08.04.2004 "PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8450, DATË 24.2.1999 "PËR PËRPUNIMIN, TRANSPORTIMIN DHE TREGËTIMIN E NAFTËS, GAZIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE", si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 129, datë 18.03.1999 "PËR PROÇEDURAT DHE KUSHTET PËR DHËNIEN E LEJEVE E TË AUTORIZIMEVE PËR TREGËTIMIN E NAFTËS, TË GAZIT E TË NËNPRODUKTEVE TË TYRE" të ndryshuar me Vendimet e Këshillit të Ministrave Nr. 170, datë 25.04.2002 & Nr. 563, datë 27.08.2004 "PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME PËR PROÇEDURAT DHE KUSHTET PËR DHËNIEN E LEJEVE E TË AUTORIZIMEVE PËR TREGËTIMIN E NAFTËS, TË GAZIT E TË NËNPRODUKTEVE TË TYRE", Bashkia Korçë jep autorizime për personat juridikë apo fizikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre për tregëtimin e karburanteve për automjete (stacionet e shitjes së karburanteve) dhe për shitjen e lëndëve djegëse (njësitë e shitjes së lëndëve djegëse) në territorin e Bashkisë Korçë. Autorizimet jepen nga Bashkia Korçë **për një periudhë deri në 5 (pesë) vjet** me të drejtë përsëritjeje dhe pagesa për dhënie autorizimi për dy kategoritë e mësipërme është si më poshtë vijon :

* Pagesë për dhënie autorizimi për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës për automjete dhe vajra lubrifikante **100.000 lekë.**
* Pagesë për dhënie autorizimi për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse dhe bombolave të gazit të lëngshëm të naftës **50.000 lekë.**

**Struktura e ngarkuar për dhënien e këtij autorizimi është Qendra e Liçensimit pranë Drejtorisë së Kontrollit të Territorit të Bashkisë Korçë.**

## B. TARIFAT VENDORE

| I. | LLOJI I TARIFËS | VLERA |
|---|---|---|
| 1. | **TARIFË REGJISTRIMI (PËR LEJE USHTRIMI VEPRIMTARIE EKONOMIKE)** | |
| | - Për persona juridikë, shtetërorë & privatë, vendas & të huaj, biznes i vogël apo i madh | 20.000 lekë |
| | - Për persona fizikë vendas & të huaj biznes i madh | 20.000 lekë |
| | - Për persona fizikë vendas & të huaj biznes i vogël | 15.000 lekë |
| | - Për persona fizikë që bëjnë tregëti dhe kryejnë shërbime ambulante | 2.500 lekë |
| | - Për persona që do të hapin aktivitet **artizanat** gjatë vitit 2010 si gurgëdhëndës, hekurpunues, riparime rrobaqepsie, punime artistike dore etj si këto | 0 lekë |

Dixhitalizuar nga Qendra QIP
www.infocip.org

| | | |
|---|---|---|
| | - Për persona **studentë** të diplomuar në Universitetin "Fan Stilian Noli" Korçë në vitet 2007, 2008, 2009 dhe gjatë vitit 2010 do të hapin aktivitet gjatë vitit 2010.<br>- Për persona **studentë** të diplomuar jashtë qytetit të Korçës & jashtë Shqipërisë për periudhën 2005 – 2010 dhe që do të kthehen në Korçë për të hapur aktivitet gjatë vitit 2010<br>- Për persona që do të hapin aktivitet **që ka lidhje me teknologjitë e informacionit** gjatë vitit 2010 si tregëtim & riparim kompjutera, kurse për mësimin e kompjuterit, salla interneti etj si këto<br>- Për persona që do të hapin aktivitet **çerdhe, kopshte, shkolla, kurse për mësimin e gjuhëve të huaja, librari, terrene sportive, kënde lojnash për fëmijë, qendra për të moshuarit, kinema dhe përkujdesje fëmijësh**<br>- Për persona që do të hapin aktivitet me objekt **turizmin si shtëpi tradicionale që ofrojnë shërbimin e fjetjes dhe mëngjes, Agjensi Turistike, autobusi shëtitës turistik, lokale me muzikë live, restorante me muzikë tradicionale korçare (serenata) si dhe agjensi organizimi eventesh të ndryshme festive**<br>- 10 (dhjetë) bizneset që do të hapen në kuadrin e **projektit shërbime punësimi për të rinjtë** (Young Enterpreneur Service)<br>- 10 (dhjetë) bizneset që do të hapen në kuadrin e **projektit të UNICEF – it** | 0 lekë<br>0 lekë<br>0 lekë<br>0 lekë<br>0 lekë<br>0 lekë<br>0 lekë |
| 2. | **TARIFË PËR PASTRIM DHE HEQJE MBETURINASH**<br>- për konvikte, pensione, shtëpi pushimi, spitale, martenitete<br>• shtetërore<br>• private<br>- për mjedise administrative (zyra, salla mbledhjesh)<br>• shtetërore<br>• private<br>- për institucione social – kulturore, sportive, ekspozita & panaire<br>- **Për subjektet e ndërtimit seli administrative :**<br>• Biznes i madh<br>- **Për subjektet e ndërtimit B.V & B.M :**<br>• Njësi ndërtimi (për çdo kantier ndërtimi, rrugë, shkolla, kopshte, objekte banimi kolektive e tregëtare, zyra dhe të tjera të ngjashme me to)<br>• Njësi ndërtimi banesa individuale<br>• rikonstruksion i pjesshëm<br>• rikonstruksione të pjesshme banesa individuale<br><br>**KUR VEPRIMTARIA KLASIFIKOHET ME T.V.SH**<br>- për njësi tregëtimi, shërbimi e artizanati<br>- për çdo njësi prodhimi | <br><br>30 lekë vit / dhomë<br>750 lekë vit / dhomë<br><br>100 lekë vit / dhomë<br>750 lekë vit / dhomë<br>10.000 lekë vit / njësi<br><br>40.000 lekë në vit<br><br>70.000 lekë / kantier<br>10.000 lekë / kantier<br>35.000 lekë / kantier<br>5.000 lekë / kantier<br><br><br>30.000 lekë në vit<br>60.000 lekë në vit |

Dixhitalizuar nga Qendra ÇIP www.infocip.org

| | | |
|---|---|---|
| | - për çdo njësi hoteli. moteli, pikë turistike<br>- për çdo njësi supermarketi Biznes i Madh<br>Për të gjithë subjektet e **Biznesit të Vogël** shuma e tarifave të pastrimit, ndriçimit dhe gjelbërimit nuk duhet të kalojë **10% të nivelit tregues të taksës**, sipas tabelës së taksimit të subjekteve të biznesit të vogël.<br>▶ **Tarifa e Pastrimit** | 60.000 lekë në vit<br>50.000 lekë në vit<br><br><br><br><br>75% e 10 përqindëshit |
| 3. | **TARIFË REKLAME**<br><br>- e thjeshtë dhe elektronike | <br><br>22.500 lekë/m2/vit |
| 4. | **TARIFË PARKIMI**<br>- autovetura taksi 8 + 1<br>- autovetura taksi 4 + 1<br>- autobusë<br>- autovetura<br>- automjet transport malli deri 3,5 T (me ngarkesë)<br>- automjet transport malli mbi 3,5 T (me ngarkesë)<br>- motomjet transport malli (motokarro)<br>- në vendparkime të rezervuara për autovetura dhe motokarro<br>- në vendparkime të rezervuara për automjete transport malli<br>- në vendparkime publike me pagesë<br>**Shënim :**<br>* Tarifa e parkimit për automjet e transportit të mallit deri dhe mbi 3,5 T (me ngarkesë) gjatë çertifikimit të tyre do të paguhet për 5 (pesë) vjet pasi edhe çertifikata dhe liçenca jepet për një periudhë 5 vjeçare, kjo sipas udhëzimit nr.11 datë 18.12.2009 të MPPTT – së.<br>Ndërsa për rastet e subjekteve të cilat disponojnë liçenca të lëshuara në periudhat e mëparshme, sipas udhëzimit të mësipërm çertifikatat do të lëshohen sipas afatit të vlefshmërisë së liçencës dhe tarifa e parkimit do të llogaritet sipas këtij afati. | <br>8.000 lekë / vit<br>4.000 lekë / vit<br>15.000 lekë / vit;50 lek /orë<br>1.500 lekë /vit<br>2.000 lekë / vit *<br>1.500 lekë / vit *<br>1.500 lekë / vit<br><br>10 lekë / orë<br><br>20 lekë / orë<br>50 lekë / orë |
| 5. | **TARIFË PËR THERJEN E BAGËTIVE**<br>a – Tarifë për therje në thertoren e Bashkisë<br>- Gjedhë<br>- Të imta<br>- Derra<br><br>b – Tarifë për çertifikimin në thertoren private<br>- Gjedhë<br>- Të imta<br>- Derra<br><br>c – Tarifë për çertifikimin e mallrave për import – export<br>- çertifikatë vërtetim për export<br>- çertifikatë vërtetim për import<br>- çertifikatë vërtetim për kafshë luksi<br>- kafshë dhe shpendë gjahu | <br><br>500 lekë<br>200 lekë<br>300 lekë<br><br><br>200 lekë<br>50 lekë<br>50 lekë<br><br><br>3.000 lekë<br>5.000 lekë<br>1.000 lekë<br>1.000 lekë |

Dixhitalizuar nga Qendra CIP
www.infocip.org

| | | |
|---|---|---|
| | d - Tarifë për çertifikatë për mallra që qarkullojnë brenda vendit (Produkte ushqimore me origjinë shtazore) | 1.000 lekë |
| 6. | **TARIFË PËR TAVOLINA JASHTË LOKALEVE** | 50 lekë/ditë/tavolinë |
| 7. | **TARIFË PËR M² MUR TË JASHTËM PËR ÇDO NDËRTESË TË RE** | 20 lekë |
| 8. | **TARIFË PËR SERVITUTIN E KALIMIT NË PRONAT PUBLIKE** | |
| | - Për zonën qendër qyteti dhe bulevardet kryesore | |
| | • rrugë kalimi | 180 lek/m² në muaj |
| | • hapësirat e tjera | 250 lek/m² në muaj |
| | - Për zonat e tjera të qytetit | |
| | • rrugë kalimi | 150 lek/m² në muaj |
| | • hapësirat e tjera | 200 lek/m² në muaj |
| 9. | **TARIFË GJELBËRIMI** | |
| | - ***Çdo njësi prodhimi :*** | |
| | • Biznes i madh | 3.000 lekë në vit |
| | - ***Për subjektet e ndërtimit seli administrative :*** | |
| | • Biznes i madh | 2.000 lekë në vit |
| | - ***Për subjektet e ndërtimit B.V & B.M :*** | |
| | • Njësi ndërtimi (për çdo kantier ndërtimi, rrugë, shkolla, kopshte, objekte banimi kolektive e tregëtare, zyra dhe të tjera të ngjashme me to) | 5.000 lekë / kantier |
| | • Njësi ndërtimi banesa individuale | 1.000 lekë / kantier |
| | • rikonstruksion i pjesshëm | 2.500 lekë / kantier |
| | • rikonstruksione të pjesshme banesa individuale | 500 lekë / kantier |
| | - ***Çdo njësi shërbimi dhe artizanati :*** | |
| | • Biznes i madh | 3.000 lekë në vit |
| | - ***Profesione të lira :*** (mjek, mjek laborant, stomatolog, farmacist, klinika e shërbime të tjera mjekësore) | |
| | • Biznes i madh | 3.000 lekë në vit |
| | - ***Profesione të lira :*** (avokat, noter, ekonomist kontabël të miratuar, ekspert kontabël të autorizuar, botues, inxhinier, arkitekt, projektues, mësues, veteriner, agronom, murator, karpentier, elektriçist etj, profesione të lira të cilat ushtrohen në njësi fikse apo ambiente të ndryshme si dhe galeritë e artit të piktorëve, skluptorëve dhe artistëve të tjerë që prodhojnë dhe tregëtojnë objekte artistike) | |
| | • Biznes i madh | 3.000 lekë në vit |
| | - ***Çdo njësi tregëtimi me shumicë e pakicë, restorante, bar – bufe, pub, diskoteka, lojra fati etj :*** | |
| | • Biznes i madh | 3.000 lekë në vit |
| | - ***Çdo njësi hoteli, moteli, komplekse turistike :*** | |
| | • Biznes i madh | 5.000 lekë në vit |
| | - ***Për institucione social – kulturore, sportive, ekspozita, panaire etj :*** | |
| | • Biznes i madh | 4.000 lekë në vit |
| | - ***Për çdo njësi supermarketi :*** | |
| | • Biznes i madh | 5.000 lekë në vit |
| | - ***Për institucionet & mjediset administrative shtetërore :*** | 5.000 lekë në vit |

Dixhitalizuar nga Qendra ÇIP
www.infocip.org

| | | |
|---|---|---|
| | - *Për Partitë politike & shoqatat*<br>Për të gjithë subjektet e **Biznesit të Vogël** shuma e tarifave të gjelbërimit, pastrimit dhe ndriçimit nuk duhet të kalojë **10% të nivelit tregues të taksës**, sipas tabelës së taksimit të subjekteve të biznesit të vogël. ▶ **Tarifa e Ndriçimit** | 2.500 lekë në vit<br><br><br><br>10% e 10 përqindëshit |
| 10. | **TARIFË PËR PËRDORIM TË TREGUT TË LIRË TË QYTETIT**<br>a) Për tregëtim mallra industriale<br>b) Për tregëtim mallra ushqimore, fruta – perime, vezë<br>c) Për tregëtim mish, peshk, bulmet | <br>30 lek/m2/ditë<br>40 lek/m2/ditë<br><br>50 lek/m2/ditë |
| 11. | **TARIFË PËR EKSPOZIM MALLI JASHTË DYQANIT** | 30 lek/m2/ ditë |
| 12. | **TARIFË DHËNIE LEJE**<br>• Kantina<br>- zona A<br>- zona B<br><br>• Kënde lojnash | <br><br>60 lek/m2/ditë<br>40 lek/m2/ ditë<br><br>40 lek/m2/ditë |
| 13. | **TARIFË NDRIÇIMI**<br>- ***Çdo njësi prodhimi :***<br>• Biznes i madh<br>- ***Për subjektet e ndërtimit seli administrative :***<br>• Biznes i madh<br>- ***Për subjektet e ndërtimit B.V & B.M :***<br>• Njësi ndërtimi (për çdo kantier ndërtimi, rrugë, shkolla, kopshte, objekte banimi kolektive e tregëtare, zyra dhe të tjera të ngjashme me to)<br>• Njësi ndërtimi banesa individuale<br>• rikonstruksion i pjesshëm<br>• rikonstruksione të pjesshme banesa individuale<br>- ***Çdo njësi shërbimi dhe artizanati :***<br>• Biznes i madh<br>- ***Profesione të lira :*** (mjek, mjek laborant, stomatolog, farmacist, klinika e shërbime të tjera mjekësore)<br>• Biznes i madh<br>- ***Profesione të lira :*** (avokat, noter, ekonomist kontabël të miratuar, ekspert kontabël të autorizuar, botues, inxhinier, arkitekt, projektues, mësues, veteriner, agronom, murator, karpentier, elektriçist etj, profesione të lira të cilat ushtrohen në njësi fikse apo ambiente të ndryshme si dhe galeritë e artit të piktorëve, skluptorëve dhe artistëve të tjerë që prodhojnë dhe tregëtojnë objekte artistike)<br>• Biznes i madh<br>- ***Çdo njësi tregëtimi me shumicë e pakicë, restorante, bar – bufe, pub, diskoteka, lojra fati etj :***<br>• Biznes i madh<br>- ***Çdo njësi hoteli, moteli, komplekse turistike :***<br>• Biznes i madh<br>- ***Për institucione social – kulturore, sportive, ekspozita, panaire etj :*** | <br><br>6.500 lekë në vit<br><br>5.000 lekë në vit<br><br><br>3.000 lekë / kantier<br>1.000 lek / kantier<br>2.000 lek / kantier<br>500 lek / kantier<br><br>6.500 lekë në vit<br><br>6.500 lekë në vit<br><br>6.500 lekë në vit<br><br>6.500 lekë në vit<br><br>7.500 lekë në vit |



Dixhitalizuar nga Qendra cip www.infocip.org

| | | |
|---|---|---|
| | • Biznes i madh<br>- *Për çdo njësi supermarketi :*<br>• Biznes i madh<br>- *Për institucionet & mjediset administrative shtetërore :*<br>- *Për Partitë politike & shoqatat*<br>Për të gjithë subjektet e **Biznesit të Vogël** shuma e tarifave të ndriçimit, pastrimit dhe gjelbërimit nuk duhet të kalojë **10% të nivelit tregues të taksës**, sipas tabelës së taksimit të subjekteve të biznesit të vogël. ▶**Tarifa e Gjelbërimit** | 6.500 lekë në vit<br><br>7.500 lekë në vit<br><br>5.000 lekë në vit<br>2.500 lekë në vit<br><br>15% e 10 përqindëshit |
| 14. | **TARIFË LEJE NON STOP**<br>- Lojra fati dhe kazinot<br>- Karburante<br>- Bar – restorante (ku zhvillohen ceremoni), diskoteka, pub, lokale live<br>- Bar – Bufe etj | <br>30.000 lekë në vit<br>15.000 lekë në vit<br>15.000 lekë në vit<br>1.000 lekë në vit |

**15. TARIFË REKLAMIMI TË BIZNESEVE NË REVISTËN E BASHKISË "QYTETI IM" DHE NË FAQEN E INTERNETIT TË FESTËS SË BIRRËS**

➢ **Reklamim tek Revista "Qyteti im" :**

Vendosja e reklamave :

| VENDI | REKLAMA ME NGJYRA |
|---|---|
| FAQE E PLOTË | 25.000 Lekë |
| 1/2 E FAQES | 12. 500 Lekë |

Vende speciale :

| VENDI | REKLAMA ME NGJYRA |
|---|---|
| KOPERTINA E PASME | 43.500 Lekë |
| FAQJA E BRENDSHME E KOPERTINËS SË PASME | 31.000 Lekë |
| FAQJA E BRENDSHME E KOPERTINËS | 37.500 Lekë |
| SALLONI FAQE A | 37.500 Lekë |
| SALLONI FAQE B | 37.500 Lekë |

➢ **Reklamim tek faqja e internetit e Festës së Birrës :**

Logo, person kontakti, adresa, numër tel ose e-mail 10.000 lekë/muaj

Logo, person kontakti, adresa, numër tel ose e-mail dhe link 20.000 lekë/muaj

1. Tarifë regjistrimi për leje ushtrimi veprimtari ekonomike paguhet vetëm një herë në momentin e rregjistrimit fillestar të subjektit dhe veprimtarisë së tij ekonomike pranë organit tatimor vendor. Taksapaguesit duhet të regjistrojnë çdo vendndodhje të biznesit sipas dokumentacionit të përcaktuar. Dhënia e lejes për ushtrim veprimtarie bëhet bazuar në kërkesën e personit që do të ushtrojë aktivitet dhe verifikimin në vend nga inspektorët e Drejtorisë së Kontrollit të Territorit. Leja për ushtrim veprimtarie ekonomike merret përpara se

Dixhitalizuar nga Qendra CIP www.infocip.org

taksapaguesi të filloje aktivitetin dhe gjithmonë pas kryerjes së pagesës të tarifës të përcaktuar në lidhje me të. Përjashtim nga pagesa e tarifës së regjistrimit për leje ushtrim veprimtarie bën ajo kategori subjektesh për të cilët kjo tarifë është 0 (zero) për vitin 2010. **Struktura e ngarkuar për dhënien e kësaj leje për ushtrim veprimtarie është Qendra e Liçensimit pranë Drejtorisë së Kontrollit të Territorit të Bashkisë Korçë.**

2. Tarifa për pastrim dhe heqje mbeturinash është detyrim vjetor i taksapaguesit. Afati i pagesës është brenda datës 31 mars të vitit fiskal për subjektet e regjistruara dhe për subjektet e reja në momentin kur lind detyrimi. Theksojmë se kur detyrimi për tarifën lind 6 mujorin e dytë të vitit fiskal pagesa do të jetë 50% e detyrimit. **Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës për pastrim dhe heqje mbeturinash është Drejtoria e të Ardhurave pranë Bashkisë Korçë.**
3. Tarifa e reklamës përfshin të gjitha elementet e palëvizshëm që shërbejnë për reklamimin e bizneseve apo aktiviteteve të ndryshme që mund të shihen nga hapësira publike e rrugës (tabelat më të mëdha se 50cm X 60cm, mbishkrimet, vizatimet, reklamat ndriçuese, reklama elektronike, stenda, shtylla dhe sipërfaqe të ndryshme që përdoren për shënime). Detyrimi i kësaj tarife është vjetor dhe pagesa bëhet paralelisht me pagesën e taksave dhe tarifave të tjera. **Struktura e ngarkuar për dhënie leje për të vendosur reklamë është Qendra e Liçensimit pranë Drejtorisë së Kontrollit të Territorit të Bashkisë Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë e Kontrollit të Zhvillimit bazuar në kërkesën e subjektit që do të vendosë reklamë, ndërsa për vjeljen e kësaj tarife ngarkohet Drejtoria e të Ardhurave pranë Bashkisë Korçë.**
4. Përsa i përket tarifës së parkimit **Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së parkimit është Qendra e Liçensimit pranë Drejtorisë së Kontrollit të Territorit të Bashkisë Korçë dhe Drejtoria e të Ardhurave pranë Bashkisë Korçë.**
5. Përsa i përket tarifës për therrjen e bagëtive **Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës për therrjen e bagëtive është Sektori i Kontrollit Veterinar Zooteknik pranë Drejtorisë së Kontrollit të Territorit të Bashkisë Korçë.**
6. Tarifa për tavolina jashtë lokaleve është tarifë e përkohshme. **Struktura e ngarkuar për dhënie leje për të vendosur tavolina jashtë lokaleve, përllogaritjen e vlerës mujore së kësaj tarife, vjeljen dhe penalitetet për mos zbatim të saj (bazuar në rregulloret përkatëse) është Qendra e Liçensimit pranë Drejtorisë së Kontrollit të Territorit të Bashkisë Korçë, bazuar në kërkesën e subjektit që do të vendosë tavolina, dhe me pas lista e lejeve të dhëna me subjektet dhe numrin e tavolinave përkatëse me të cilat do të shërbehet jashtë lokalit çohet në Drejtorinë e Financës ku subjektet duhet të paraqiten periodikisht (çdo muaj) për të kryer pagesën për tarifën e shërbimit me tavolina jashtë lokalit bazuar në tarifën e vendosur nga Këshilli i Bashkisë Korçë.**
7. Përsa i përket Tarifës për $m^2$ mur të jashtëm për çdo ndërtesë **Struktura e ngarkuar për përllogaritjen dhe vjeljen e kësaj tarife, është Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit Urban pranë Bashkisë Korçë.**
8. Përsa i përket Tarifës për servitutin e kalimit në pronat publike **Struktura e ngarkuar për matjen, përllogaritjen dhe vjeljen e kësaj tarife, është Drejtoria e Kontrollit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e Kontrollit të Zhvillimit Urban pranë Bashkisë Korçë.**
9. Tarifat e gjelbërimit dhe e ndriçimit janë detyrime vjetore të taksapaguesve. Afati pagesës është brenda datës 31 mars të vitit fiskal për subjektet e regjistruara dhe për subjektet e reja në momentin kur lind detyrimi. Theksojmë se kur detyrimi për tarifat lind 6 mujorin e dytë të vitit fiskal pagesa do të jetë 50% e detyrimit. **Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifave për ndriçim dhe gjelbërim është Drejtoria e të Ardhurave pranë Bashkisë Korçë.**

Dixhitalizuar nga Qendra CIP www.infocip.org

10. Përsa i përket tarifës për përdorimin e tregut të lirë të qytetit për tregun industrial dhe atë të fruta – perimeve **Struktura e ngarkuar për matjen, përllogaritjen dhe vjeljen e kësaj tarife, është Sektori i Tregjeve pranë Drejtorisë së të Ardhurave të Bashkisë Korçë,** ndërsa për tarifën e përdorimit të tregut të lirë të qytetit për merkaton e mishit dhe atë të peshkut **Struktura e ngarkuar për matjen, përllogaritjen dhe vjeljen e kësaj tarife, është Drejtoria Juridike e Bashkisë Korçë e cila përpilon edhe kontratat e qerasë me subjektet që ushtrojnë aktivitetin e tyre në këto ambjente.**
11. Përsa i përket tarifës për ekspozim malli jashtë dyqanit **Struktura e ngarkuar për dhënie leje për të ekspozuar mall jashtë dyqanit, përllogaritjen e vlerës mujore së kësaj tarife, vjeljen dhe penalitetet për mos zbatim të saj (bazuar në rregulloret përkatëse) është Qendra e Liçensimit pranë Drejtorisë së Kontrollit të Territorit të Bashkisë Korçë, bazuar në kërkesën e subjektit që do të ekspozojë mall jashtë dyqanit, dhe me pas lista e lejeve të dhëna me subjektet dhe sipërfaqet përkatëse në të cilat do të ekspozohet mall jashtë dyqanit çohet në Drejtorinë e Financës ku subjektet duhet të paraqiten periodikisht (çdo muaj) për të kryer pagesën për tarifën për ekspozim malli jashtë dyqanit bazuar në tarifën e vendosur nga Këshilli i Bashkisë Korçë.**
12. Përsa i përket tarifës për dhënie leje kantina **Struktura e ngarkuar për dhënie leje kantinë, përllogaritjen e vlerës mujore së kësaj tarife, vjeljen dhe penalitetet për mos zbatim të saj (bazuar në rregulloret përkatëse) është Qendra e Liçensimit pranë Drejtorisë së Kontrollit të Territorit të Bashkisë Korçë, bazuar në kërkesën e subjektit që do të ushtrojë aktivitet kantinë, dhe me pas lista e lejeve të dhëna me subjektet dhe sipërfaqet përkatëse në të cilat do të ushtrohet ky aktivitet çohet në Drejtorinë e Financës ku subjektet duhet të paraqiten periodikisht (çdo muaj) për të kryer pagesën për tarifën dhënie leje kantinë bazuar në tarifën e vendosur nga Këshilli i Bashkisë Korçë.**
13. Tarifë "leje non stop" është tarifë e cila do të paguhet nga subjekte të cilët do të ushtrojnë veprimtarinë e tyre ekonomike **mbas orës 23.00** dhe që do të pajisen me lejen përkatese për të zhvilluar aktivitetin e tyre mbas këtij orari. Leja non stop do tu jepet atyre subjekteve të cilët më parë e kanë kërkuar këtë leje nga Bashkia Korçë, kërkesë kjo e cila duhet të jetë e shoqëruar me firmat e mbi ¾ të banorëve të komunitetit të zonës përreth. Hapësira e zonës përreth dhe komuniteti i saj do të vlerësohen nga inspektorët e Drejtorisë së Kontrollit të Territorit. Kjo leje do të jepet vetëm pas kryerjes së pagesës së plotë të tarifës së "lejës non stop" nga ana e subjekteve. **Struktura e ngarkuar për dhënie "leje non stop" përllogaritjen e vlerës së kësaj tarife, vjeljen dhe penalitetet për mos zbatim të saj (bazuar në rregulloret përkatëse) është Qendra e Liçensimit pranë Drejtorisë së Kontrollit të Territorit të Bashkisë Korçë, bazuar në tarifën e vendosur nga Këshilli i Bashkisë Korçë.**
14. Përsa i përket tarifave për reklamimin e aktivitetit të bizneseve në faqet e revistës së Bashkisë Korçë dhe në faqen e internetit të festës së birrës **strukturat e ngarkuara për vjeljen e këtyre tarifave janë Sektori i Publikimeve dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Marketingut dhe Turizmit të qytetit.**

## C. TARIFA TË SHËRBIMIT ADMINISTRATIV TË BASHKISË KORÇË

### *1) – TARIFA TË SHËRBIMIT ARKIVOR, VËRTETIME NGA ZYRAT DHE KOMISIONE PËR SHËRBIMIN PRANË ARKËS SË BASHKISË*

- Tërheqje Vendime të K.K.K.P; K.RR.T.Bashkiak **500 lekë.**

Dixhitalizuar nga Qendra CIP www.infocip.org

- Tërheqje e gjithë dokumentave të tjera përveç atyre të sipërpërmendura dhe njehsim i tyre me origjinalin nga Arshiva e Bashkisë Korçë **100 lekë/dokumenti**.
- Marrje vërtetimi nga çdo zyrë e Bashkisë Korçë **100 lekë/vërtetim**.
- Komisione për shërbimin te arka për pagesa mbi 1.000 lekë – **100 lekë/veprim**.

***2) – TARIFA PËR SHËRBIMIN NË FUSHËN E TRANSPORTIT TË PASAGJERËVE & MALLRAVE DHE DHËNIEN E LEJEVE PËR USHTRIM AKTIVITETI NGA QENDRA E LIÇENSIMIT PRANË DREJTORISË SË KONTROLLIT TË TERRITORIT TË BASHKISË KORÇË***

| Nr. | Emërtimi | Njësia | Tarifa në lekë Afati pesë vjeçar |
|---|---|---|---|
| **I** | **TRANSPORT UDHETARËSH** <br> Brenda vendit | | |
| 1. | Liçencë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetëse. | Për linjë | 40.000 |
| | - Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetëse. | Për mjet | 5.000 |
| 2. | Liçencë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rrethqytetëse. | Për linjë | 20.000 |
| | - Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rrethqytetëse. | Për mjet | 7.500 |
| 3. | Liçencë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt ndërqytetëse brenda qarkut ose ndërmjet qarqeve. | Për linjë | 75.000 |
| | - Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt ndërqytetëse brenda qarkut ose ndërmjet qarqeve. | Për mjet | 7.500 |
| 4. | Liçencë për transport udhëtarësh me taksi | Për mjet | 20.000 |

| Nr. | Emërtimi | Njësia | Tarifa në lekë Afati pesë vjeçar |
|---|---|---|---|
| **II** | **TRANSPORT MALLRASH** <br> Brenda vendit | | |
| 1. | Liçencë për transport mallrash për të tretë dhe me qira. | Për liçencë | 40.000 |
| | - Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qira. | Ton/kapac. | 100* |
| 2. | Çertifikatë për transport për transport mallrash për llogari të vet . | Ton/kapac. | 100* |
| 3. | Çertifikatë për tërheqës. | Për mjet | 7.500 |

Dixhitalizuar nga Qendra CIP www.infocip.org

| | | | |
|---|---|---|---|
| **III** | **SHËRBIME TRANSPORTI** | | |
| 1. | Liçencë për agjensi transporti udhëtarësh dhe taksi brenda vendit. | Për liçencë | 15.000 |
| 2. | Liçencë për agjensi transporti ndërkombëtar udhëtarësh. | Për liçencë | 40.000 |
| **IV** | **VEPRIMTARI TË TJERA** | | |
| | Aurorizim i përkohshëm një mujor. | Për autoriz. | 2.000 |

Shënim :

* Vlefta e dalë nga llogaritja e ton/kapacitet do të shumëzohet me pesë.

a) Për dublikatë me të njëjtën përmbajtje dhe afat vlefshmërie paguhet 30% e vlerës së plotë.

b) Për rastet e ndryshimeve në liçencë/çertifikatë që kanë të bëjnë me elementet e përdoruesit të mjetit, fushës së operimit etj, paguhet 30% e vlerës së plotë.

► Tarifë shërbimi për liçencë, çertifikatë ose autorizim në fushën e transportit 200 lekë

► Dhënie autorizimi për lëvizje të automjeteve mbi 3,5 ton brenda unazës për periudha të përkohshme

* Automjete masa maksimale e autorizuar mbi 3,5 T – = 7,5 T
3.000 lekë/vit/mjet ose 250 lekë/muaj/mjet

* Automjete masa maksimale e autorizuar mbi 7,5 T – = 12 T
6.000 lekë/vit/mjet ose 500 lekë/muaj/mjet

* Automjete masa maksimale e autorizuar mbi 12 T – = 18 T
9.000 lekë/vit/mjet ose 700 lekë/muaj/mjet

* Automjete masa maksimale e autorizuar mbi 18 T
12.000 lekë/vit/mjet ose 1.000 lekë/muaj/mjet

► Leje apo çertifikatë vjetore (specifike përveç tarifës së regjistrimit për leje ushtrimi veprimtari ekonomike, bazuar në regulloret përkatëse) për veprimtari servis të automjeteve, lavazheve, parkingut, pika tregëtimi materiale ndërtimi (inerte, gëlqere etj të ngjashme me to) **5.000 lekë**

► Liçensë vjetore për lejimin e aktivitetit në përgatitjen e kursantëve për automjete (Autoshkolla) **5.000 lekë**

**Të gjitha lejet për zhvillimin e aktiviteteve specifike jepen nga Qendra e Liçensimit pranë Drejtorisë së Kontrollit të Territorit të Bashkisë Korçë.**

**Drejtoria e Politikave të Zhvillimit, Planifikimit strategjik dhe Koordinimit me donatorët, përcakton llojet e aktiviteteve që kërkojnë leje specifike si dhe kriteret për dhënien e tyre.**

### *3) – TARIFA TË SHËRBIMIT NË ZYRËN E GJENDJES CIVILE*

- Transferimi i të dhënave të gjendjes civile nga Zyra e Gjendjes Civile të Vendbanimit të mëparshëm në atë të vendbanimit të ri (me përjashtim të rasteve të transferimit brenda Bashkisë) 1.000 lekë
- Veprime për ndarje familjare të shtetasve 200 lekë
- Veprime për bashkime familjare të shtetasve 200 lekë
- Ndarje familjare e përsëritur 0 lekë
- Bashkim familjar i përsëritur 0 lekë
- Lidhje martese 600 lekë
- Lëshim leje lidhje martese në gjuhë të huaj 200 lekë



Dixhitalizuar nga Qendra CIP www.infocip.org

- Lëshim çertifikate martese në gjuhë të huaj 200 lekë
- Lëshim çertifikate 50 lekë
- Lëshim çertifikate lindje në gjuhë të huaj 200 lekë
- Ndërrim emri ose mbiemri 700 lekë
- Vendime të emetuara (ndreqje gabimesh, ndryshim gjeneralitetesh, etj) 50 lekë
- Regjistrim lindje me vonesë 2.000 lekë
- Regjistrim vdekje me vonesë 1.000 lekë

***4) – TARIFA TË SHËRBIMIT TË STREHIMIT***

- Përgatitje dokumentacioni për privatizim objektesh të kthyera në fond banese **100 lekë**.
- Përgatitje dokumentacioni për të pastrehët **100 lekë**.

***5) – TARIFA TË INSPEKTORIATIT TË KONTROLLIT MBI TERRITORIN***

- Dhënie çertifikate pastërtie për firmat e ndërtimit (leje ndërtimi dhe leje shfrytëzimi) **500 lekë**.

***6) – TARIFA TË INSPEKTORIATIT TË NDËRTIMIT***

- Dhënie dëshmie penaliteti për firmat e ndërtimit **500 lekë**.

***7) – TARIFA TË DREJTORISË SË PLANIFIKIMIT URBAN DHE PROJEKTEVE & DREJTORISË SË KONTROLLIT TË ZHVILLIMIT***

a. Shqyrtimi i dosjeve për leje ndërtimi dhe kalim për miratimin përkatës pranë Bashkisë Korçë :

| | |
|---|---|
| - Banesa Individuale | **500 lekë** |
| - Banesa të grupuara, kolektive, industriale | **2.000 lekë** |
| b. Kontrolli i piketimit të objekteve : | |
| - për objekte deri në 3 kate mbi tokë | **500 lekë** |
| mbi 3 kate mbi tokë | **2.000 lekë** |
| c. Kontrolli pas përfundimit të themeleve : | |
| - për objekte deri në 3 kate mbi tokë | **500 lekë** |
| mbi 3 kate mbi tokë | **2.000 lekë** |
| d. Kontrolli pas përfundimit të karabinasë : | **500 lekë për kat** |
| e. Kontrolli i sistemimit të ambjentit rrethues pas përfundimit të punimeve : | |
| - për objekte deri në 3 kate mbi tokë | **500 lekë** |
| mbi 3 kate mbi tokë | **2.000 lekë** |
| f. Tërheqje leje shfrytëzimi : | |
| - për objekte deri në 3 kate mbi tokë | **2.000 lekë** |
| mbi 3 kate mbi tokë | **6.000 lekë** |
| g. Fotokopjimi i planshetave në shkallën 1/500, 1/2000 : | |
| Format A4 | **200 lekë** |
| Format A3 | **300 lekë** |
| Format A1 | **1.000 lekë** |
| Format A0 | **1.500 lekë** |
| h. Tarifë plan vendosje (GENT – PLANIT) | **3.000 lekë** |

***8) – TARIFA PËR RAJONET ADMINISTRATIVE***

| | |
|---|---|
| * Lëshim vërtetimi për banor lagjeje | **100 lekë** |
| * Lëshim vërtetimi për të pastrehët | **100 lekë** |
| * Kryerja e proçedurave për ndarje ose bashkim familjar | **200 lekë** |
| * Kryerja e proçedurave për dhënie leje banimi | **200 lekë** |
| * Dhënie firme për hipotekimin e pronave private që janë të kufizuara me pronën publike | **500 lekë** |
| * Dhënie autorizimi për pensionistët | **falas** |

Dixhitalizuar nga Qendra CIP www.infocip.org

## D. TARIFA TË INSTITUCIONEVE TË VARËSISË

### *1) NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE KORÇË*

- Lëshim vërtetimi **100 lekë/vërtetim.**
- Dhënie me qera autovinçin **2.500 lekë/orë.**
- Prerje asfalti me prerësen e asfaltit **100 lekë/m linear.**
- Çmimi i shitjes së drurëve sipas moshës së tyre :

| Nr. | Emërtimi i bimësisë | Mosha e drurëve dhe çmimi i shitjes | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 1-3 vjeçare | 4-6 vjeçare | 7-10 vjeçare | 11-15 vjeçare | mbi 15 vjet |
| 1 | Bredh | 150 | 3000 | 5000 | 7000 | 10000 |
| 2 | Pishë | 150 | 3000 | 5000 | 7000 | 10000 |
| 3 | Cedrus | 150 | 3000 | 5000 | 7000 | 10000 |
| 4 | Selvi | 100 | 1500 | 2000 | 2500 | 3000 |
| 5 | Mështekna | 100 | 2500 | 2500 | 3500 | 5500 |
| 6 | Gështenja | 100 | 2500 | 3500 | 4500 | 6000 |
| 7 | Panja amerikane | 200 | 1000 | 1500 | 2500 | 3000 |
| 8 | Panja mali | 300 | 1000 | 2000 | 3000 | 4000 |
| 9 | Katalpa | 500 | 1000 | 1500 | 2000 | 2500 |
| 10 | Kumbull e kuqe | 100 | 1500 | 2000 | 2500 | 3000 |
| 11 | Sofora | 200 | 1000 | 1500 | 2500 | 3500 |
| 12 | Lojfata | 200 | 1000 | 1500 | 2500 | 3500 |
| 13 | Plepa | 50 | 100 | 200 | 300 | 500 |
| 14 | Blinj | 100 | 200 | 3000 | 4000 | 5500 |
| 15 | Akacje | 100 | 500 | 800 | 1000 | 1250 |
| 16 | Frashër | 300 | 600 | 800 | 1000 | 1500 |
| 17 | Shelgje | 50 | 100 | 200 | 500 | 800 |
| 18 | Ara indi | 300 | 700 | 1100 | 1600 | 2000 |
| 19 | Rrap | 100 | 1000 | 3500 | 4500 | 3000 |
| 20 | Hunap | 100 | 1000 | 3500 | 4500 | 3000 |
| 21 | Verri | 100 | 1000 | 1500 | 2000 | 2500 |

- Çmimi i shitjes së shkurreve dekorative sipas moshës së tyre :

| Nr. | SHKURRE | Mosha e shkurreve dhe çmimi i shitjes | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 1-2 vjeçare | 3-4 vjeçare | 5-8 vjeçare | 9-10 vjeçare | mbi 10 vjet |
| 1 | Trëndafila | 100 | 200 | 300 | 400 | 500 |
| 2 | Ligustra | 60 | 120 | 1500 | 2000 | 2500 |
| 3 | Tuja e zakonshme | 200 | 400 | 3000 | 6000 | 8000 |
| 4 | Tuja lejland | 200 | 400 | 6000 | 8000 | 10000 |
| 5 | Tuja aurea | 200 | 400 | 6000 | 8000 | 10000 |
| 6 | Tuja zmeral | 100 | 400 | 3000 | 4000 | 5000 |
| 7 | Dëllinjë kineze | 100 | 400 | 3000 | 5000 | 7000 |
| 8 | Qershiçka | 100 | 300 | 500 | 700 | 1000 |
| 9 | Spirea | 100 | 300 | 500 | 700 | 1000 |
| 10 | Hibiskus | 100 | 300 | 500 | 700 | 1000 |
| 11 | Budlea | 100 | 300 | 500 | 700 | 1000 |
| 12 | Forsythje | 100 | 300 | 500 | 700 | 1000 |
| 13 | Citisus | 100 | 300 | 500 | 700 | 1000 |
| 14 | Cidonja | 100 | 300 | 500 | 700 | 1000 |
| 15 | Jargavanë | 100 | 300 | 500 | 700 | 1000 |
| 16 | Filadentrus | 100 | 300 | 500 | 700 | 1000 |
| 17 | Vegelia | 100 | 300 | 500 | 700 | 1000 |
| 18 | Bignoja | 100 | 300 | 500 | 700 | 1000 |
| 19 | Keria | 100 | 300 | 500 | 700 | 1000 |

Dixhitalizuar nga Qendra QIP
www.infocip.org

- Çmimi i shitjes së luleve në vazo :

| Nr | Emërtimi | Çmimi |
|---|---|---|
| 1 | Aspiragus | 300 |
| 2 | Fikus | 900 |
| 3 | Shqiponjë | 1000 |
| 4 | Sedium | 400 |
| 5 | Mastika | 400 |
| 6 | Bela perona | 400 |
| 7 | Aloe arborensu | 400 |
| 8 | Lule akulli | 300 |
| 9 | Karfica | 300 |
| 10 | Livando | 300 |
| 11 | Atallzi | 300 |
| 12 | Ruskus | 300 |
| 13 | Beganja | 400 |
| 14 | Palma uji | 400 |
| 15 | Fier | 400 |
| 16 | Klorofikum | 200 |
| 17 | Aspidistra | 200 |
| 18 | Zambak i kuq | 200 |
| 19 | Gjemb me pika | 300 |
| 20 | Tradiskania lila | 200 |
| 22 | Palm e zakonshme | 600 |
| 23 | Filadentrum | 400 |
| 24 | Ksindapsus | 300 |
| 25 | Sansaverina | 400 |
| 26 | Ekeveria | 300 |
| 27 | Kaktus | 400 |
| 28 | Sterlica | 1000 |
| 29 | Dafina | 600 |
| 30 | Hedera | 400 |
| 31 | Karafila | 100 |
| 32 | Kallo | 25 |

- Çmimi i shitjes së kurorave dhe buqetave me lule :

| Nr | Emërtimi | Çmimi |
|---|---|---|
| 1 | Kurora me lule | 2500 |
| 2 | Kurora varrimi | 150 |
| 3 | Buqeta feste | 500 |
| 4 | Buqeta e thjeshtë | 100 |

### *2) DREJTORIA MBËSHTETËSE E ARSIMIT KORÇË*

Kuota ushqimore mujore që paguhet nga prindërit për 7 (shtatë) kopshtet dhe 1 (një) çerdhe në territorin e Bashkisë Korçë janë si më poshtë vijon :

- Kopshti nr 8 **2.000 lekë në muaj**
- Kopshti nr 10 **1.500 lekë në muaj**
- Kopshti nr 12 **2.000 lekë në muaj**
- Kopshti nr 14 **2.000 lekë në muaj**
- Kopshti nr 16 **1.500 lekë në muaj**
- Kopshti nr 17 **2.000 lekë në muaj**
- Kopshti nr 18 **1.500 lekë në muaj**
- Çerdhe **1.800 lekë në muaj**

### *3) QENDRA KULTURORE "VANGJUSH MIO"*

Dixhitalizuar nga Qendra ÇIP www.infocip.org

- Tarifa e dhënies në përdorim të sallës **2.500 lek në orë**
- Vlera e biletës për të vizituar muzeun "Bratko" **100 lek**
- Vlera e biletës për të vizituar muzeun "Bratko" për nxënësit e shkollave, studentët dhe konviktorët **50 lek**
- Vlera e biletës për të vizituar galerinë "Guri Madhi" **falas**
- Vlera e biletës për të vizituar ekspozita të ndryshme **falas**

*4) BIBLIOTEKA "THIMI MITKO" & "THOMA TURTULLI"*

- Tarifa e dhënies në përdorim të sallës **2.500 lek në orë**
- Shërbim hapje kartele biblioteka "Thimi Mitko" **500 lek**
- Shërbim hapje kartele biblioteka "Thoma Turtulli" **falas**
- Shërbim interneti për anëtarët e bibliotekës "Thimi Mitko" **falas**

*5) TEATRI "ANDON ZAKO ÇAJUPI"*

- Tarifa e dhënies në përdorim të sallës **20.000 lek në orë**
- Shfaqjet e organizuara për fëmijë (kopshte & shkolla) **50 lekë**
- Shfaqjet e lira për publikun **200 lekë – 300 lekë**
- Vlera e biletës për nxënësit e shkollave, studentët dhe konviktorët do të jetë **100 lekë**

**E. LLOJET DHE NIVELET E GJOBAVE QË DO TË VENDOSEN NGA INSPEKTORËT E DREJTORISË SË KONTROLL TERRITORIT NË RASTET E SHKELJEVE DHE KUNDËRVAJTJEVE ADMINISTRATIVE**

| **1. Niveli i gjobave për kryerjen e aktivitetit tregëtar pa liçensë, autorizim apo leje përkatëse të jetë si më poshtë :** | |
|---|---|
| **a.** Mospajisja me liçensë, autorizim apo çertifikatë përkatëse transporti :<br>• motokarro<br>• transport udhëtarësh taksi (1+4)<br>• transport udhëtarësh taksi (1+8)<br>• mjete të tonazhit të lartë<br>• hyrja pa autorizim në rrugët kryesore të qytetit për mjetet e tonazhit të lartë | <br><br>2.000 lek<br>10.000 lek<br>15.000 lek<br>20.000 lek<br>15.000 lek |
| **b.** Mospajisje me leje për tregëtimin me pakicë të karburanteve dhe njësive të shitjes së lëndeve djegëse dhe bombulave të gazit | 10.000 deri 50.000 lek |
| **c.** Mospajisje me leje për tregëti ambulante, kantinë | 5.000 deri 10.000 lek |
| **d.** Mos pajisje me leje për shërbim me tavolina jashtë lokalit | 5.000 deri 10.000 lek/tavolinë |
| **e.** Mospajisje me leje për ushtrim aktiviteti "24 orësh" | 10.000 deri 20.000 lek |

Dixhitalizuar nga Qendra CIP www.infocip.org

| | |
|---|---|
| **f.** Mospajisje me leje për zenie të hapësirës publike<br>• ekspozim malli<br>• veprimtarive të cilat do të zhvillohen në hapësirat publike | 5.000 deri 10.000 lek<br><br>5.000 deri 10.000 lek |
| g. Mospajisje me leje për vendosje reklame :<br>• e thjeshtë<br>• elektronike | 10.000 deri 15.000 lek<br>20.000 deri 25.000 lek |
| **h.** Mosmarrja e masave për izolimin e ambjentit për daljen e zhurmave nga ambjentet e lokaleve. | 25.000 lek |

**2. Niveli i gjobave për dëmtim dhe ndërhyrje në infrastrukturën rrugore të jetë si më poshtë :**

| | |
|---|---|
| **a.** Dëmtim rruge | 10.000 deri 30.000 lek/ m² |
| **b.** Çarje rruge | 30.000 deri 50.000 lek/ m² |
| **c.** Bllokim rruge | 5.000 deri 20.000 lek/ml |
| **d.** Dëmtim bordure | 10.000 deri 20.000 lek/ml |
| **e.** Dëmtim trotuari | 10.000 deri 30.000 lek/ m² |
| **f.** Çarje trotuari | 30.000 deri 50.000 lek/ m² |
| g. Bllokim trotuari | 5.000 deri 20.000 lek/ml |
| **h.** Dëmtim, bllokim, vjedhje pusete | 10.000 deri 30.000 lek/copë |
| **i.** Ndotje të rrugëve nga mjetet e transportit për punime në qytet :<br>- persona juridikë<br>- persona fizikë<br>- qytetarë | <br><br>50.000 lek<br>20.000 lek<br>5.000 lek |

**3. Niveli i gjobave për dëmtimet dhe ndërhyrjet në rrjetin e ndriçimit rrugor të jetë si më poshtë :**

| | |
|---|---|
| **a.** Lidhje e pamiratuar në rrjetin ajror | 10.000 deri 20.000 lek/copë |
| **b.** Dëmtim të shtyllave të ndriçimit | 20.000 deri 30.000lek/copë |
| **c.** Dëmtim i ndriçuesve | 5.000 deri 10.000 lek/copë |
| **d.** Përdorimi i shtyllave të ndriçimit si suport për montimin e reklamave, kapjen e kabllove etj. | 5.000 deri 10.000 lek/copë |
| **e.** Dëmtim i traseve, kabllove dhe linjave ajrore nga punimet që kryhen pranë tyre me leje dhe pa leje si dhe shkulja e shtyllave | 20.000 deri 40.000 lek/copë |
| **f.** Ndërhyrje në kuadrot elektrik publik | 10.000 deri 20.000 lek/copë |

**4. Niveli i gjobave për dëmtime dhe ndërhyrje në rrjetin e ujësjellësit :**

Dixhitalizuar nga Qendra ÇIP www.infocip.org

| | |
|---|---|
| **a.** Lidhje e pa miratuar në tubacion | 10.000 deri 20.000 lek/copë |
| **b.** Dëmtim i pusetave | 10.000 deri 20.000 lek/copë |
| **c.** Dëmtimi i tubacioneve nga punimet që kryhen pranë tyre me leje ose pa leje | 20.000 deri 40.000 lek/copë |
| **5. Niveli i gjobave për ndërhyrje dhe dëmtime në hapësirat e gjelbëra dhe publike të jetë si më poshtë :** | |
| **a.** Dëmtim i hapësirave publike të gjelbërta | 10.000 deri 20.000 lek/m² |
| **b.** Dëmtim, prerje e pemëve | 10.000 deri 50.000 lek/copë |
| **c.** Zënie e hapësires të gjelbër pa leje | 5.000 deri 20.000 lek/m² |
| **d.** Vendosje tabelash, pankartash, banderolash pa leje | 1.000 deri 10.000 lek/copë |
| **e.** Vendosje posterash pa leje | 100 deri 200 lek/copë |
| **f.** Mos ndërtimi i bazamenteve të kontenierëve të mbetjeve urbane të subjekteve të ndërtimit për objektet mbi 5 kate | 10.000 lek |
| **6.Niveli i gjobave per inspektoriatin veterinar të jetë si më poshtë :** | |
| **a.** Për mishin e therur të tregëtuar të pa çeritifikuar nga Inspektoriati Veterinar | 5.000 deri 10.000 lek |
| **b.** Mbajtja e kafshëve të prodhimit brenda territorit të Bashkisë. | 10.000 deri 20.000 lek për herë të parë, për rast të përsëritur deri në konfiskim të kafshës |
| **c.** Në rast të mosmarrjes së masave për izolimin kafshëve te luksit | 2.000 deri 5.000 lek |

- Të ardhurat e realizuara nga mbledhja e gjobave do të ndahen sipas përcaktimit që bën Ligji Nr.7697 datë 07.04.1993 "Për kundërvajtjen administrative", të ndryshuar.
- Mbeten në fuqi të gjitha gjobat e tjera që janë miratuar me ligj ose me V.K.B dhe që nuk janë përmendur në këtë material.
- Përjashtohen nga pagimi i gjobave vetëm rastet e parashikuara me ligj të veçantë.
- Për zbatimin e këtyre penaliteteve ngarkohen të gjitha Drejtoritë në Bashki e veçanërisht Drejtoria e Kontroll Territorit.

Mbeten në fuqi të gjitha taksat dhe tarifat e tjera që janë miratuar me Ligj ose me V.K.B dhe që nuk janë përmendur në këtë material.

Për nënkategorinë "Njësi – çdo kantier ndërtimi", llogaritja e tarifës bëhet për periudhën nga momenti i ngritjes së kantierit të ndërtimit deri në momentin e dorëzimit nga subjekti pranë Bashkisë Korçë të kërkesës për leje shfrytezimi.

Të gjitha subjektet ndërtuese do të tërheqin lejen e ndërtimit pranë Bashkisë Korçë vetëm pasi të kenë paguar detyrimet përkatese për selinë administrative dhe për "çdo kantier ndërtimi", si dhe pasi të kenë paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë.

Subjektet e biznesit të madh paguajnë detyrimet për njësinë qëndrore si të tillë dhe si ato të biznesit të vogël për çdo njësi tjetër të tyre sipas llojit të aktivitetit që kryejnë.

Përjashtohen nga pagesa të gjitha rastet e parashikuara me Ligj.

Dixhitalizuar nga Qendra
www.infocip.org

Pagesa e taksave vjetore, kur detyrimi i pagesës lind 6/mujorin e parë do të bëhet e plotë dhe kur lind 6/mujorin e dytë do të jetë ½ e vlerës së taksës dhe tarifës.

Mbledhja e tyre do të bëhet nga vetë strukturat e Bashkisë dhe agjentët tatimorë të përcaktuar sipas ligjit.

**2.** Për diskutimin dhe votimin për miratimin e tarifave për familjarët pastrim, ndriçim dhe gjelbërim, do të bëhet në mbledhjen e ardhshme të Këshillit Bashkiak.

Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohen të gjitha Drejtoritë në Bashki e veçanërisht Drejtoria e të Ardhurave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Gjergji PENDAVINJI

Dixhitalizuar nga Qendra ÇIP
www.infocip.org